

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Filologjisë

Emërtimi i lëndës: **Hyrje në studimet albanistike**

Departamenti: Gjuhë Shqipe

Niveli i kursit: Bachelor, lëndë e detyrueshme (obligueshme)

Viti I, Semestri: II

Fondi i orëve: 2 +0

Kodi:

Vlera në kredite ETCS: 6

Koha dhe vendi i ligjëratave:

Mësimdhënësi: dr. Sedat Kuçi, profesor i rregullt

Zyra 132 (69), tel. 038/ 222 970; e-mail: sedat.kuqi@ uni-pr.edu

Konsultime: e hënë 12,00-13,00; e martë 12,00-13,00;

Qëllimi i kursit:

Kursi Hyrje në studimet albanistike synon t’ua përkufizojë studentëve nocionin dhe shtrirjen e studimeve albanistike si dhe të japë një historik të shkurtër, themelor, të studimeve albanistike në botë dhe në viset shqiptare. Kursi klasifikon fushat e studimeve albanistike, periudhat dhe autorët kryesorë.

Rezultatet e pritura:

Në përfundimin e këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- të njohë rrezen e studimeve albanistike;
- të njohë problemet kryesore të albanistikës si disiplinë;
- të njohë periudhat kryesore të zhvillimit të albanistikës;
- të njohë autorët kryesorë të huaj dhe shqiptarë që kanë kontribuar për zhvillimin e albanistikës;

Metodologjia e mësimdhënies:

- ligjëratata, studim individual dhe në grupe

Literatura bazë:

KASTRATI, J.: Historia e albanologjisë. Në tre vëllime. Vëllimi i parë (1497-1853). Vëllimi i dytë (maj 1854- maj 1942). Vëllimi i tretë (1944-1997). Tiranë 2000.

KASTRATI, J.: Histori e gramatologjisë, Tiranë 1980.

LUKA, D.: Histori e gjuhësisë shqipe, Shkodër 2005.

SHUTERIQI, Dh.: Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë 1976 (u rishtyp në Prishtinë).

ISMAJLI, R. : Tekste të vjetra, Dukagjini, Pejë, 2000.

ISMAJLI, R. : Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003.

Plani i detajizuar

- Java 1.** STUDIMET ALBANISTIKE DHE HISTORIA E GJUHËS SHQIPE:
Objekti i kursit, periodizimi i historisë së gjuhës shqipe dhe i studimeve albanistike. Bibliografi dhe revista albanistike.
- Java 2.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE-LINGUISTIKE I:
Veprat para vitit 1854. I: A. von Harff, Gj. Buzuku dhe P. Budi dhe studimet mbi veprën e tyre.
- Java 3.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE-LINGUISTIKE II:
Veprat para vitit 1854. II: F. Bardhi, P. Bogdani, N. Veqilharxhi dhe studimet mbi veprën e tyre.
- Java 4.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE-LINGUISTIKE III:
Veprat para vitit 1854. III.: W. Martin-Leake, J. von Xylander, G. von Hahn
- Java 5.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE-LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE IV:
Albanistika dhe Rilindja Kombëtare Shqiptare I
- Java 6.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE V:
Rilindja Kombëtare Shqiptare II
Leksikologjia dhe gramatologjia
Vlerësimi i parë intermediar (test)
- Java 7.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE VI:
Rilindja Kombëtare Shqiptare III
Alfabeti, drejtshkrimi dhe dialektologjia
- Java 8.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE VII:
Rilindja Kombëtare Shqiptare IV:
Etimologjia, onomastika dhe studime albanistike mbi Rilindjen Kombëtare
- Java 9.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE VIII:
Përsosja e shqipes pas vitit 1912-1944
- Java 10.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE IX:
Shqipja dhe albanistika prej vitit 1945 deri më 1972:
- Java 11.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE X:
Shqipja moderne dhe albanistika I:
Studime mbi përsosjen e shqipes dhe mbi tendencat e zhvillimit të saj
- Java 12.** SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË TROJET SHQIPTARE XI:

Shqipja moderne dhe albanistika II:

Doracakët e shqipes moderne

Java 13. SHQIPJA ME RËNDËSI KULTURORE – LINGUISTIKE NË DIASPORËN SHQIPTARE:

Studimet mbi shqipen në Itali dhe në Greqi

Java 14. SHQIPJA SI OBJEKT I SHKENCAVE KRAHASIMTARE:

Shqipja dhe indoevropianishtja.

Java 15. SHQIPJA SI OBJEKT I SHKENCAVE KRAHASIMTARE:

Shqipja dhe ballkanistika.

Provimi përfundimtar me test (vlerësohet me 50%)

Metodat e vlerësimit (me test):

Vlerësimi i parë intermediar (test): 35%

Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive: 10%

Vijimi i rregullt: 5%

Provimi përfundimtar me test 50%

Gjithsej 100%

Literatura shtesë:

PEKMEZI, G. et. al.: Albanesische Bibliographie, Wien 1909.

LEGRAND, E.: Bibliographie Albanaise. Paris-Athenes 1912.

HETZER, A., ROMAN, V.S.: Albanien. Ein bibliographischer Forschungsbericht, Munchen 1983.

LLOGARITJA E NGARKESËS SË STUDENTIT

KONTRIBUTI NË NGARKESËN E STUDENTIT

AKTIVITETI	ORË	DITË/JAVË	GJITHSEJ
LIGJËRATA	2	15	30
USHTRIME TEORIKE	1	15	15
KONTAKTET ME MËSIMDHËNËSIN KONSULTIMET PËR STUDENT NË JAVË 10 MIN.		15	150 MIN. = 2,5 ORË
KOLOKVIUME, SEMINARE	1	15	15
DETYRA TË SHTËPISË	2	2	4
KOHA E STUDIMIT VETANAK TË STUDENTIT(NË BIBLIOTEKË OSE NË SHTËPI)	3	15	45

PËRGATITJA PËRFUNDIMTARE

PËR PROVIM	15	2	30
KOHA E KALUAR NË VLERËSIM (TESTE, KUIZ, PROVIM FINAL)	1,5	3	4,5
PROJEKTET, PREZANTIMET, ETJ.	1,5	1	1,5

 NGARKESA TOTALE 146,5 ORË

$$146,5 : 25 = 5,86 \text{ KREDITE-ECTS}$$